



**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE**

# **PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6-18 MUAJSH**

## **MUAJI MARS**



*PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS*

**Tema mujore: Pranvera**



**Tema e Javës: Njohim pranverën**

| Java I                | Rubrika                                                                                                                | Aktivitetet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Mjetet e Punës                                                                                        |
|-----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>E Hënë</b></p>  | <p><b>Mirë se vjen pranverë!</b></p>  | <p><b>Kënga:</b> “Erdhi pranvera”<br/> <b>Identifikimi</b> me gisht i figurave të lidhura me pranverën (lule, pema, zogu, flutura, etj.) në libra me përralla.<br/> <b>Emërtimi</b> i figurave nga edukatorja, duke i ndarë fjalët në rrokje.<br/> <b>Muzikë</b> për fëmijë.</p>                                                                                                                                                                                                          | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Libra, revista</p>                                          |
| <p><b>E Martë</b></p> | <p><b>Ngjyrat e pranverës</b></p>   | <p><b>Kënga:</b> “Erdhi pranvera”<br/> <b>Identifikimi</b> me gisht i ngjyrave (e kuqe/ blu/ e verdhë/ e gjelbër) në libra me përralla ose figura.<br/> <b>Emërtimi</b> i ngjyrave nga edukatorja. Edukatorja pyet dhe përgjigjet vetë: “Çfarë ngjyre ka pema, zogu, lulja, dielli” etj?<br/> <b>Aktivitet “Ngjyrat e pranverës”</b><br/>                     Edukatorja hedh në një karton të bardhë pika boje dhe vendos sipër një qese. Fëmijët prekin me duar e këmbë qesen për të hapur bojërat në të, derisa të krijohet një lloj “pikturë” me ngjyra të ndryshme.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Mjete didaktike (letër kartoni/ tabak, bojëra akrilike)</p> |





|                         |                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                 |
|-------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>E Mërkurë</b></p> | <p><b>Dielli/ Shiu</b></p>    | <p><b>Kënga:</b> “Si është koha”</p> <p>Në varësi të kohës zgjedhim aktivitetin:<br/> <b>Dielli me bojëra:</b> Fëmijët pikturojnë me duar diellin (si në foto).<br/> OSE<br/> <b>Shiu:</b> Me pambuk krijojmë retë dhe me një shishe plastike të mbushur me ujë, improvizojmë shiun.<br/> <b>Vjersha:</b> “Shiu”</p>                                            | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve<br/> Pambuk, letra me ngjyra, bojëra</p>  |
| <p><b>E Enjte</b></p>   | <p><b>Lulet</b></p>           | <p><b>Kënga:</b> “Erdhi pranvera”<br/> <b>Vjersha:</b> “Manushaqja”/“Mimoza”<br/> Ilustrojmë me lule natyrale.</p> <p><b>Lojë ndijore:</b> Njohim dhe prekim lulet: Edukatorja nxit fëmijët të prekin lule natyrale, të mbledhura më parë, emërton dhe përforcon ndjesinë.<br/> <b>Aktivitet:</b> Edukatorja ndihmon fëmijët të ngjisin lulet në një fletë.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve<br/> Lule natyrale, fleta, ngjitës</p>                                                                                       |
| <p><b>E Premte</b></p>  | <p><b>Lojë ndijore</b></p>  | <p><b>Kënga:</b> “Erdhi pranvera”</p> <p><b>Lojë ndijore me tullumbace:</b> Edukatorja fryn disa tullumbace jo plotësisht, të cilat i mbush me materiale të ndryshme. Tullumbacet i varim mes dy shtretërve dhe i përdorim që fëmijët t’i prekin dhe të përjetojnë ndjesi të ndryshme.</p> <p><b>Përrallë</b> e lirë në grup.</p>                               | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve.</p> <p>Tullumbace me ngjyra të ndryshme dhe materiale si: ujë, pambuk, oriz, etj.</p>                                       |

### Tema mujore: Pranvera




### Tema e Javës: Festat dhe elementët e pranverës

| Java II | Rubrika                                                                                                                                                                                                         | Aktivitetet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Mjetet e Punës                                                                                                                                                           |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| E Hënë  | <b>7 Marsi: Festa e Edukatores</b><br><br> | <p><b>Krijojmë lule</b> për edukatoret përmes pikturimit me gishta duke përdorur ngjyra të ndryshme dhe letra me ngjyra.</p> <p>Krijojmë <b>muzikë</b> duke përdorur mjete rrethanore të grupit dhe kërcejmë sipas <b>ritmit</b>.</p> <p><b>Vjersha:</b> « Edukatorja »</p>  | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Bojëra, letra me ngjyra</p> <p>Mjete rrethanore për të krijuar tingujt (shishe plastike, mjete prej druri, metalike, etj.)</p> |

|                         |                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                         |
|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>E Martë</b></p>   | <p><b>8 Marsi: Festa e Mamin</b></p>  | <p><b>Krijojmë kartolina/ lule</b> për mamin përmes pikturimit me gishta duke përdorur ngjyra të ndryshme dhe letra me ngjyra.</p> <p><b>Këngë</b> dhe <b>vjersha</b> për mamin.</p> <p><b>Muzikë</b> për fëmijë.</p>  | <p>Manuali i Këngëve dhe Vjershave</p> <p>Bojëra, letra me ngjyra</p>                                   |
| <p><b>E Mërkurë</b></p> | <p><b>Flutura</b></p>                 | <p><b>Vjersha:</b> “Flutura”</p> <p><b>Punë dore:</b> “<b>Krijimi i fluturës</b>” me ngjitje. Edukatorja krijon një flutur me letër ose mjete të riciklueshme. Fëmijët e grupit ngjisin krahët me ndihmën e edukatores.</p> <p><b>Përralla:</b> “Tre fluturat”</p>                                        | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Libri me përralla</p> <p>Letra me ngjyra, ngjitës</p>         |
| <p><b>E Enjte</b></p>   | <p><b>Zogu</b></p>                  | <p><b>Vjersha:</b> “Ciu-ciu”/“Dallëndyshja”</p> <p><b>Lojë imituese:</b> Imitojmë zogun (tingujt, cicërima dhe fluturimin e tij.</p> <p><b>Përralla</b> “Rosaku i shëmtuar”/ “Ciu-ciu kërkon mamin”.</p>                                                                                                  | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Mjete didaktike: letra, ngjyra.</p> <p>Libër me përralla.</p> |




|                 |                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                          |
|-----------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E Premte</b> | <p style="text-align: center;"><b>Ylberi</b></p>  | <p><b>Vjersha:</b> “Flutura”</p> <p><b>Kënga:</b> “Erdhi pranvera”</p> <p><b>Aktivitet me ngjitje:</b> Edukatorja krijon një ylber si në foto dhe fëmijët ndihmohen të ngjisin pambukun për të formuar renë dhe shiritat me ngjyra për të krijuar ylberin (foto).</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Letra me ngjyra, gërshërë, një tabak për të punuar ylberin</p> |
|-----------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|


**Tema mujore: Pranvera**

**Tema e Javës: Frutat dhe Perimet e Stinës**



| <b>Java III</b> | <b>Rubrika</b>                                                                                                                                | <b>Aktivitetet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <b>Mjetet e Punës</b>                                                                          |
|-----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E Hënë</b>   | <p style="text-align: center;"><b>Frutat e stinës</b></p>  | <p><b>Vjersha:</b> “Qershia”</p> <p><b>Kënga:</b> “Frutat”</p> <p><b>Punë dore:</b> Edukatorja parapërgatit forma prej letre të frutave të stinës dhe ua tregon fëmijëve duke i emërtuar ato.</p> <p><b>Demonstrim</b> i frutit të ditës, fëmijët prekin dhe njohin përmes shqisave tiparet e frutit (molla, portokalli).</p> <p><b>Përrallë</b> e lirë.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Letra me ngjyra, gërshërë</p> <p>Fruta të stinës</p> |


|                         |                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                          |
|-------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>E Martë</b></p>   | <p><b>Perimet e stinës</b></p>       | <p><b>Vjersha:</b> “Karota”<br/> <b>Punë dore:</b> Edukatorja parapërgatit forma prej letre të perimeve të stinës dhe ua tregon fëmijëve duke i emërtuar ato.<br/> <b>Aktivitet:</b> Edukatorja identifikon me gisht perimet dhe tregon emrat e tyre.<br/> <b>Demonstrim</b> i perimeve të ditës, fëmijët prekin dhe njohin përmes shqisave vetitë e perimeve.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve<br/>         Letra me ngjyra, gërshëra<br/>         Libra me figura<br/>         Perime të stinës</p> |
| <p><b>E Mërkurë</b></p> | <p><b>Përgatitja e ushqimit</b></p>  | <p><b>Loja:</b> “Bëj sikur gatuj” me mjete plastike gatimi.<br/> <b>Vjersha:</b> “Etika e të ngrënit”<br/> <b>Aktivitet:</b> Edukatorja identifikon perimet, si përbërësit kryesorë të supës. Përsërit emrat e tyre dhe stimulon fëmijët që t’i emërtojnë ato.<br/> <b>Përrallë</b> e lirë.</p>                                                                    | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve<br/>         Lodra plastike/ set gatimi<br/> <br/>         Perime të stinës</p>                       |
| <p><b>E Enjte</b></p>   | <p><b>Etika e të ngrënit</b></p>   | <p><b>Vjersha:</b> “Etika e të ngrënit”<br/> <b>Edukatorja</b> u demonstroi fëmijëve shtrimin e tavolinës gjatë vakteve duke emërtuar dhe treguar elementët e saj: mbulesa e tavolinës, pjata, luga, gota, uji, kartpecetat, gushoret, etj.<br/> <b>Krijime artistike</b> me frutat e stinës (Treni, Avioni, Zemra, Dielli; foto)</p>                              | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve<br/> <br/>         Mjetet e shtrimit të tavolinës<br/> <br/>         Fruta dhe perime</p>             |

|                 |                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                           |
|-----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E Premte</b> | <p><b>Një ditë në piknik</b></p>  | <p><b>Përsëritje e</b> vjershave dhe këngëve.</p> <p><b>Improvizim</b> pikniku duke përdorur fruta/ perime të ndryshme dhe duke demonstruar shtrimin e mbulesës.</p> <p><b>Përrallë:</b> “Pikniku i Arushit Tedi”</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Fruta, perime të ndryshme, mbulesë</p> <p>Libri me përralla</p> |
|-----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|





**Tema mujore: Pranvera**

**Tema e Javës: Veshjet, ngjyrat, numrat, format**



| <b>Java IV</b> | <b>Rubrika</b>                                                                                                        | <b>Aktivitetet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                             | <b>Mjetet e Punës</b>                                                   |
|----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>E Hënë</b>  | <p><b>Veshjet në pranverë</b></p>  | <p><b>Bisedë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve si vishemi në pranverë, demonstrim me veshjet e fëmijëve. i tregojmë, i prekim, i emërtojmë, numërojmë.</p> <p><b>Loja:</b> Fusim dhe nxjerrim rrobat/ veshjet në kosh dhe nga koshi.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Xhepi im i vogël”/ “Jam një vajzë simpatike”</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Veshje/ rroba</p> <p>Kosh</p> |



|                  |                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                         |
|------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>E Martë</b>   | <p style="text-align: center;"><b>Numrat 1 dhe 2</b></p>         | <p><b>Kënga:</b> “Lepuri” (kënga fillon me numërimin: 1, 2, 3, 4, 5).<br/> <b>Bisedë:</b> Edukatorja emërton numrat 1 dhe 2 dhe i konkretizon me lodra (1 top, 2 topa, 1 kukull, 2 kukulla, etj).<br/> <b>Loja:</b> Lojë me topa shumëngjyrësh.</p>                                                                                                  | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Topa me ngjyra, lodra</p>     |
| <b>E Mërkurë</b> | <p style="text-align: center;"><b>Rrethi</b></p>                 | <p><b>Vjersha:</b> “Topi”.<br/> <b>Bisedë:</b> Edukatorja vizaton një rreth dhe ua tregon fëmijëve. Emërton “rrethi” dhe e konkretizon atë me objekte (topi, ora) ose elemente natyrorë (dielli) të punuar javën e mëparshme.<br/> Fëmijët mund të bëjnë vija me ngjyra brenda rrethit, me ndihmën e edukatores.<br/> <b>Lojë</b> me tullumbace.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Letra, ngjyra, tullumbace</p> |
| <b>E Enjte</b>   | <p style="text-align: center;"><b>Rrathë në kon</b></p>         | <p><b>Loja:</b> “Futja e rrathëve me ngjyra në kon”<br/> Edukatorja emërton ngjyrat bazë sipas rrathëve dhe u kërkon fëmijëve t’i fusin rrathët në kon. Edukatorja nxit emërtimin e tyre.<br/> <i>Nëse nuk dispononi lodër të tillë në grup, e krijoni me karton.</i><br/> <b>Përrallë</b> e lirë në grup.</p>                                       | <p>Kon, rrathë</p> <p>Libër me përralla</p>                             |
| <b>E Premte</b>  | <p style="text-align: center;"><b>Luajmë dhe kërcëjmë</b></p>  | <p><b>Përsërisim</b> këngët, ngjyrat, numrat.<br/> <b>Lojë lëvizore:</b> “Duart nga e majta”<br/> <b>Kërcim</b> me muzikën për fëmijë.</p>                                                                                                                                                                                                           | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p>                                  |